

STATUT
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“Vila Vitess” SH.P.K

KAPITULLI I
KRIJIMI ,FORMA, OBJEKTI, KOHEZGJATJA, EMERTIMI, SELIA

NENI 1
KRIJIMI I SHOQERISE

Sot me daten 09.05.2019

Mbeshtetur ne ligjin nr.9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe shoqerite tregtare”,hartuam kete statut te ri te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar me emertimin “Vila Vitess” Sh.p.k.


Shoqeria eshte person juridik shqiptar e pershtatur ne perputhje me kerkesat e ligjit nr.9901 date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”. Shoqeria e ushtron aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara ne dokumentat themeluese (Akt Themelimi dhe Statut)

NENI 2
FORMA E SHOQERISE

Shoqeria do te kete formen e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar, per sa kohe qe Ortaket e kesaj shoqerie nuk do te marre nje vendim per shnderrimin e saj ne nje shoqeri anonime. Veprimtaria e shoqerise do te rregullohet nga dispozitat perkatese te ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare “.

NENI 3
EMERTIMI

Emertimi i shoqerise eshte “Vila Vitess” Sh.p.k. Ne te gjitha aktet dhe dokumentet e nxjerra nga shoqeria , emertimi i shoqerise do te ndiqet nga fjalet “Shoqeri me Pergjegjesi te kufizuar” ose inicialet sh.p.k



NENI 4

SELIA

Shoqeria e ka seline ne qytetin e Tiranes, ne adresen : Rruga Ibrahim Rrugova, Vila 33 Tirane.

Pervec veprimtarise ne nivel lokal , shoqeria ka te drejten e krijimit dhe mbylljes se filialeve , agjencive dhe zyrave te perfaqesimit brenda apo jashte territorit te Republikes se Shqiperise.

Selia mund te transferohet ne cdo vend tjeter brenda territorit te Republikes se Shqiperise, me nje vendim te Ortakeve te kesaj shoqerie.

NENI 5

KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e shoqerise eshte me afat te papercaktuar , duke filluar qe nga data e rregjistrimit te saj ne Q K R , Tirane.

Ne perputhje me kete statut , shoqeria mund te mbylle veprimtarine e saj kur e sheh te arsyeshme, apo ne rastet e parashikuara me ligj.

NENI 6

OBJEKTI

Objekti i veprimtarise se shoqerise “Vila Vitess” Sh.p.k. do te shtrihet ne keto fusha veprimi :

1. Ne fushen e sherbimit: Bar - Restorant – Piceri.

Kryerja e cdo operacioni ekonomik e juridik, prodhues dhe tregtar e financiar, qe lidhet drejtperdrejt ose terthorazi me objektin e veprimtarise se shoqerise ,per te cilin , ne baze te legjislacionit shqiptar ,kerkohet leje e posacme nga organet kompetente te administrates publike ,do te realizohet vetem pasi te jete siguruar leja perkatese.

KAPITULLI II

KAPITALI THEMELTAR ; KUOTAT DHE KALIMI I KUOTAVE

NENI 7

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali eshte fiksuar ne 100.000 (njqindemije) leke.

Kapitali ndahet ne 1 (nje) kuote me vlere nominale 100.000 (njemije) leke. Kontributi i kapitalit te neneshkruar eshte i papaguar. Ai mund te zmadhohet dhe te zvogelohet me vendim te Ortakut sipas normave te fushes ne fuqi.

NENI – 7/1

KUOTAT

Kuotat e pjesemarrjes jane 1 kuote me vlere te pergjithshme 100.000 lek ne perqindje 100% te z.Illir Fatmir Dabulla.

NENI 8

MENYRA E FITIMIT DHE KALIMIT TE KUOTAVE

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet :

- Kontribut ne kapitalin e shoqerise ;
- Shitblerjes ;
- Trashegimise ;
- Dhurimit
- Cdo menyre tjeter parashikuar ne ligj.

NENI 9

PASOJAT E KALIMIT TE KUOTAVE, PJESTIMI DHE TRANSFERIMI I TYRE

Personi qe kalon kuoten dhe ai qe e perfiton ate pergjigjen ne menyre solidare ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i kuotes, nga casti i kalimit te kuotave, deri ne castin e rregjistrimit te kalimit ,sipas pikes 2 te ketij neni.

Shoqeria realizon kalimin e kuotes ,sipas nenit 43 te ligjit nr. 9723,date 03.05.2007“Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit”.

Me perjashtim te rasteve kur kjo eshte e ndaluar nga statuti ,kuotat mund te pjesetohen per shkak te kalimit te tyre.

Nese nje prej ortakve (ortaku shites) ka si qellim ti transferoj te treteve, teresisht apo pjeserisht kuotat e shoqerise ne pronesi te tij (ne vijim kuotat e ofruara) duhet qe paraprakisht ,sipas te drejtes se parablerjes ,tia ofroj keto kuota ortakeve te tjere,nepermjet nje njoftimi me shkrim i cili duhet te permbaje emrin dhe te dhenat e blesesit ,numrin e kuotave qe ka si qellim te shese ,cmimin e shitjes dhe cdo afat apo kusht tjeter per transferimin.

Nese ortaket e tjere kane si qellim te ushtrojne te drejten e parablerjes sikurse percaktohet ne paragrafin e mesiperme(ne vijim e drejta e parablerjes) duhet te njoftoje ortakun shites (ne vijim i parablerjes),permes nje njoftimi i cili duhet te dergohet brenda dhe jo me vone se 30 dite pune nga data e marrjes se njoftimit te parablerjes .Ne pranimin e parablerjes duhet te tregohet vullneti i pakushtezuar per blerjen e te gjtiha kuotave te ofruara me te njejtat kushte per te cilat eshte rene dakord me palen e trete blesese.

Transferimi i kuotave te ofruara dhe pagesa e cmimit duhet te kryhen njekohesisht dhe brenda dites se 20-te te punes vijuese te mbarimit te afatit prej 30 diteve pune te percaktuara me siper.

Nese ortaket e tjere nuk ushtrojne te drejten e parablerjes sipas afateve te percaktuara me lart , ortakun shites eshte i lire qe kuotat e ofruara tja shese te treteve , ne

perputhje me cmimin ,afatet dhe kushtet e percaktuara ne njoftimin e parablerjes, brenda 30 diteve pune nga mbarimi i afatit te percaktuar ne paragrafin e mesiperm.

Dispozitat e nenit 9 per kalimin e kuotave zbatohen edhe per kalimin e pjeseve te kuotave.

KAPITULLI III

MARREDHENIET NDERMJET SHOQERISE DHE ORTAKEVE

NENI 10

SHPERNDARJA E FITIMEVE

Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe ne statut ,ortaket kane te drejte te ndajne pjesen e fitimit te deklaruar ne pasqyrat financiare te shoqerise.

Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe ne statut ,fitimi u shperndahet ortakeve ne raport me kuotat e zoteruara.

NENI 11

KUFIZIMET E SHPERNDARJES, CERTIFIKATA E AFTESISE PAGUESE ,PERGJEGJESITE

Shoqeria mund tu shperndaj fitim ortakeve ,vetem nese pas pagimit te dividendit :

- Aktivitet e shoqerise mbulojne teresisht detyrimet e saj ;
- Shoqeria ka aktive likuide te mjaftueshme per te shlyer detyrimet qe behen te kerkueshme Brenda 12-muajve ne vazhdim.

Administratoret leshojne nje certifikat te aftesise paguese , e cila konfirmon shprehimisht se shperndarja e propozuar e dividendeve e permbush kerkesat e paragrafit te pare te ketij neni ,ndersa kur gjendja e shoqerise tregon se shperndarja e propozuar e dividendeve nuk i permbush keto kritere ,administratoret nuk mund te leshojne kete certifikate.

Administratoret pergjigjen ndaj shoqerise per vertetesine e certifikates se aftesise paguese Administratoret te cilet nga pakujdesia leshojne nje certifikate te pasakte te aftesise paguese pergjigjen personalisht perpara shoqerise per kthimin e dividendeve te shperndare Ortaket , qe kane marre nga shoqeria dividend, pergjigjen personalisht ndaj shoqerise per kthimin e dividendeve, pavaresisht leshimit te certifikates, keta ortake kane pasur dijeni per gjendjen e paaftesise paguese te shoqerise sipas paragrafit te pare te ketij neni.


KAPITULLI IV

ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE

Organet drejtuese te shoqerise jane :

1. Asambleja e Pergjithshme
2. Administratoret

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME



NENI 12

TE DREJTAT DHE DETYRAT

Asambleja e Pergjithshme eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme :

- a) Percaktimin e politikave tregtare te Shoqerise ;
- b) Ndyshimet e statutit
- c) Emerimin dhe shkarkimin e Administratoreve
- d) Emerimin dhe shkarkimin e likujdvesve dhe eksperteve kontabel te autorizuar
- e) Percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat c dhe d te kesaj pike.
- f) Mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise .
- g) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
- h) Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit
- i) Pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre
- j) Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve
- k) Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise
- l) Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti

Nese shoqeria zoterohet nga nje ortak i vetem ,te drejtat dhe detyrimet e asamblese se pergjithshme ushtrohen nga ortaku i vetem . Te gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetem regjistrohen ne nje rregjister te vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen. Duhet regjistruar ne vecanti ,por pa u kufizuar ne to ,vendimet per :

Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise

- a) Shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve
- b) Investime
- c) Vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise


Vendimet e paregjistruara ne regjistrin e vendimeve jane absolutisht te pavlefshme . Shoqeria nuk mund ti kundrejtoje pavlefshmerine te tretit , qe ka fituar te drejta ne mirebesim, pervec rastit kur shoqeria provon se i treti ka pasur dijeni per pavlefshmerine , apo ne baze te rrethanave te qarta nuk mund te kishte pasur dijeni per te.

NENI 13

MBLEDHJA E ASAMBLESE SE PERGJITHSHME

1.Asambleja e pergjithshme mblidhet ne rastet e percaktuara nga ky ligj , nga ligje te tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa here qe mbledhja eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e shoqerise. Mbledhja e zakonshme e asamblese se pergjithshme thirret te pakten nje here ne vit .

2.Asambleja e pergjithshme thirret nga administratoret apo ortaket e percaktuar sipas nenit 84 te ketij ligji.



- 3.Asambleja e pergjithshme thirret nese , sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare , rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.
- 4.Asambleja e pergjithshme thirret kur shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive , te cilat kane nje vlere me te larte se 5% te aseteve te shoqerise ,qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
- 5.Asambleja e pergjithshme thirret kur shoqeria , brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj , propozon te bleje nga nje ortak pasuri ,qe kane vlere me te larte se 5% te aseteve te shoqerise ,qe rezultojne ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
- 6.Ne rastet e parashikuara ne pikat 3 e 5 te ketij neni Asamblese se Pergjithshme i paraqitet nje raport nga nje ekspert kontabel i autorizuar i pavarur.
- 7.Dispozitat e pikes 6 te ketij neni nuk zbatohen nese blerjet , sipas pikave 4 e 5 te ketij neni ,kryhen ne burse ose jane pjese e veprimeve te perditshme te shoqerise dhe behen ne kushte normale tregu. Gjithashtu , keto dispozita nuk zbatohen ne rastin kur shoqeria zoterohet nga nje ortak i vetem.
8. Ne rastet e parashikuara ne pikat 3 deri ne 5 te ketij neni , asambleja e pergjithshme mund te miratoje nje rezolute keshilluese ,duke miratuar apo bere verejtje per veprimtarine e administratoreve.

NENI MENYRA E THIRRJES

- 1.Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose , me njoftim npermjet postes elektronike.Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin ,daten ,oren e mbledhjes dhe rendin e dites e tu dergohet te gjithë ortakeve , jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese .
2. Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes1 te ketij neni ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithë ortaket jane dakord ,per te marre vendime , pavaresisht parregullise.

NENI 15

KERKESAT NGA ORTAKET E PAKICES

- 1.Ortaket te cilet perfaqesojne te pakten 5% te totalit te votave ne Asamblene e pergjithshme te shoqerise , apo nje pjese me te vogel te parashikuar ne statut , mund ti drejtojne administratoreve nje kerkese me shkrim , perfshire posten elektronike, per te thirrur asamblene e pergjithshme dhe /ose perfshirjen e ceshtejeve te posacme ne rendin e dites.Kerkesa duhet te permbaje arsyet , objektivat dhe ceshtjet , per te cilat asambleja duhet te marre nje vendim . Nese kerkesa refuzohet keta ortake kane te drejte ta therrasin asamblene dhe te caktojne ceshtjet e rendit te dites ne perputhje me piken 1 te nenit 83 te ketij ligji .
- 2.Nese ne kundershtrim me piken 1 te ketij neni , asambleja e pergjithshme nuk thirret , ose ceshtja e kerkuar prej tyre nuk futet ne rendin e dites , secili prej ortakeve , qe kane bere kerkesen ka te drejte :
 - a) te ngreje padi ne gjykate per te deklaruar shkeljen e detyrimit te besnikerise nese administratoret nuk permbushin kerkesat e ortakeve brenda 15 diteve.
 - b) t'i kerkoje shoqerise blerjen e kuotave te zoteruara prej tyre .



3. Ne rastet kur rendi i dites ndryshohet , sipas parashikimeve te pikave 1 e 2 te ketij neni dhe thirrja i eshte njoftuar ortakeve , administratoret njoftojne perseri rendin e dites te ndryshuar , ne perputhje me parashikimet e pikes 1 te nenit 83 te ketij ligji.

4. Perfaqesuesi i autorizuar eshte i detyruar te deklaroje cdo fakt apo rrethane te tille qe , sipa gjykimit te ortakut te perfaqesuar , rrezikon te ndikojte ne vendimmarrjen e perfaqesuesit per interesa te tjere te ndryshem nga ata te ortakut te perfaqesuar .

NENI 16

PERFAQESIMI NE ASAMBLE

1. Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjetër apo nga nje person i tretë .

2. Administratoret e shoqerise nuk mund te veprojne si perfaqesues te ortakeve ne asamblene e pergjithshme

3. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se pergjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

NENI 17

KUORUMI

1. Ne rastin e marrjes se vendimeve qe kerkojne nje shumice te zakonshme , asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortakët me te drejte vote , qe zoterojne me shume se 30% te kuotave . Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per ceshtje , te cilat kerkojne shumice te kualifikuar , sipas nenit 87 te ketij ligji , ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese ortakët qe zoterojne me shume se gjysmen e numrin total te votave jane te pranishem personalisht , votojne me shkrese , apo mjete elektronike , sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji .

2. Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorimit te permendur ne piken 1 te ketij neni , asambleja mblidhet perseri jo me vonë se 30 dite me te njejtin rend dite.

NENI 18

MARRJA E VENDIMEVE

1. Me perjashtim te rasteve kur statuti parashikon nje shumice me te larte, asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat e votave te ortakeve pjesemarrës sic parashikohet ne piken 1 te nenit 86 te ketij ligji , per ndryshim statutit , zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te rregjistruar , shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise .

2. Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe ne kete ligj ose ne (paragrafin 18.4) per ceshtjet e tjera te renditura ne nenin 81 te ketij ligji , asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarrës.

3. Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe ne kete ligj , vlefshmeria e vendimeve , qe percaktojne detyrime shtese mbi ortakët , apo vendimet qe kufizojne te

drejtat e tyre te parashikuara ne kete ligj ose ne statut , kushtezohet nga miratimi i ortakut perkates.

4.Vendimet e asamblese se pergjithshme ne lidhje ne sa me poshte , merren vlefshmerisht me voten pro te ortakeve qe perfaqesojne te pakten 50 % + 1 te kapitalit themeltar te shoqerise :

- Miratimi i bilancit
- Shperndarja e dividenteve
- Emerimi dhe /ose shkarkimi i administratoreve dhe ekspertit kontabel dhe percaktimi i shperblimit te tyre.

- Miratimi i buxhetit vjetor
- Autorizimin per nenshkrimin e cfaredolloj kontrate
- Miratimi i kerkeses per perjashtimin e njerit prej ortakeve
- Ndryshimet e statutit
- Zmadhimi dhe zvogelimi kapitalit
- Perfaqesimi i shoqerise ne gjykate
- Riorganizimi dhe prishja e shoqerise

NENI 19

E DREJTA E VOTES

1.Me Perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe ne statut , cdo kuote jep te drejten e nje vote .

2.Statuti mund te parashikoje per ortaket qe nuk jane te pranishem , mundesine pjesemarrjes ne mbledhjen e asamblese se pergjithshme me mjete te ndryshme komunikimi perfshire mjetet elektronike , me kusht qe te garantohet identifikimi I ortakeve.

3.Mjetet elektronike perfshijne , por pa u kufizuar ne to :

- a) Transmetimin e mbledhjes se asamblese se pergjithshme ne kohe reale
- b)Komunikimin e ndersjellte ne kohe reale , i cili u mundeson ortakeve te shprehen per mbledhjen e asamblese se pergjithshme nga nje vendndodhje tjeter.
- c) Mekanizmat , qe mundesojne procesin e votimin , perpara apo gjate mbajtjes se mbledhjes se asamblese se pergjithshme , pa qene nevoja te caktohet nje perfaqesues i autorizuar , per te marre pjese fizikishte ne mbledhje .

4.Perdorimi i mjeteve elektronike per tu mundesuar ortakeve te marrin pjese ne mbledhjen e asamblese se pergjithshme , behet me kushtin qe te merren masat teknike te nevojshme per garantuar identifikimin e ortakeve dhe sigurine e komunikimeve elektronike , deri ne ate mase qe ky perdorim te jete proporcional me arritjen e ketyre qellimeve.


5. Ortaket kane te drejten ,qe u njihet nga ky ligj apo statuti , per te marre unanimisht cdo vendim , me kusht qe kjo marreveshje te behet me shkrim.

NENI 20

PERJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTES

1.Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendim per :

- a) Vleresimin e veprimtarise se tij



b) Shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij

c) Ngritjen e nje padije ndaj tij nga shoqeria

d) Dhenien ose jo te perfitimeve te reja

2.Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet ,te jete ne te njejtin konflikt interesi , ashtu si edhe ortaku , te cilin perfaqeson.

NENI 21

PROCESVERBALET E MBLEDHJES SE ASAMBLESE

- 1.Te gjitha vendimet e asamblese se pergjithshme duhet te regjistrohen ne procesverbal. Administratoret pergjigjen per ruajtjen e kopjeve te procesverbaleve te mbledhjeve te asamblese se pergjithshme.
- 2.Procesverbali duhet te permbaje daten dhe vendin e mbledhjen , rendin e dites emrin e kryetarit e te mbajtesit te proces verbalit , rezultatet e votimit.
- 3.Procesverbalit i bashkelidhet edhe lista e pjesemarresve si dhe akti i thirrjes se asamblese se pergjithshme .
- 4.Procesverbali i mbledhjes nenshkruhet nga kryetari dhe nga mbjatesi i procesverbalit .
- 5.Nese shoqeria ka publikuar nje faqe ne internet , administratoret , jo me vone se 15 dite nga data e mbledhjes jane te detyruar te publikojne kopje te procesverbalit te mbledhjes te asamblese se pergjithshme ne kete faqe.

NENI 22

HETIMET E POSACME

- 1.Asambleja e pergjithshme mund te vendose nisjen e nje hetimi te posacem per parregullsite pergjate veprimeve te themelimit te shoqerise apo te ushtrimit te veprimtarise tregtare.Hetimi kryhet nga nje ekspert i pavarur i fushes.
2. Ortaket qe perfaqesojne te pakten 5% te totalit te votave ne asamblene e shoqerise, apo nje vlere me te vogel te parashikuar ne statut dhe /ose cilido kreditor i shoqerise mund ti kerkojne asamblese se pergjithshme emerimin e nje eksperti te pavarur te fushes , kur ka dyshime te bazuara per shkelje te ligjit ose te statutit.Ortaket apo kreditorët e shoqerise se percaktuar me siper , brenda 30 diteve pas refuzimit nga asambleja per emerimin e ekspertit te pavarur , mund ti kerkojne gjykates emerimin e ketij eksperti .Nese asambleja e pergjithshme nuk merr nje vendim brenda 60 diteve nga data e paraqitjes se kerkeses , kerkesa e ortakeve vleresohet e refuzuar .
- 3.Kur asambleja e pergjithshme ka emeruar nje ekspert te fushes ker kryerjen e hetimit te posacem dhe kur per kete emerim ka dyshime te bazuara per te besuar se eksperti mund te mos realizoje hetimin e posacem ne menyren e duhur , ortaket ose kreditorët e permendur ne piken 2 te ketij neni mund ti kerkojne gjykates zevendesimin e tij.
- 4.Kur gjykata pranon kerkesat e permendura ne pikat 2 e 3 te ketij neni shoqeria tregtare perballon kostot e emerimit dhe te shperblimit te ekspertit te emeruar per kryerjen e hetimit te posacem .
- 5.E drejta per te kerkuar hetim te posacem sipas pikave 1 e 2 te ketij neni duhet te ushtrohen brenda 3 vjeteve nga data rregjistrimit te shoqerise tregtare , kur hetimi ka si objekt parregullsite e procesit te themelimit , si dhe brenda 3 vjeteve nga data e veprimit , qe konsiderohet i parregullt , kur hetimi ka si objekt parregullsite e ushtrimit te veprimtarise tregtare.

6.Kreditori , qe ne keqbesim paraqet nje kerkese , sipas pikes 2 te ketij neni , pergjigjet ne perputhje me nenin 34 te Kodit te Procedures Civile.

NENI 23

SHFUQIZIMI I VENDIMEVE TE PARREGULLTA DHE DEMSHPERBLIMI

1.Asambleja e pergjithshme ka te drejte ti kerkoje gjykates perkatese shfuqizimin e vendimeve te administratoreve, kur keto perbejne shkelje te rende te ligjit ose te statutit.

2.Ortaket te cilet perfaqesojne te pakten 5% te totalit te votave ne asamblene e shoqerise , ose nje vlere me te vogel te parashikuar ne statut , apo secili prej kreditoreve te shoqerise mund ti kerkojne asamblese se pergjithshme ngritjen e padise si me siper.Ortaket apo kreditorët e shoqerise te percaktuar me siper , brenda 30 diteve pas refuzimit nga asambleja per ngritjen e padise , kane te drejte te ngrene padi drejtperdrejt perpara gjykates kompetente per shfuqizimin e vendimit te administratoreve. Nese asambleja e pergjithshme nuk merr nje vendim , brenda 60 diteve nga data e kerkeses, kerkesa e ortakeve apo e kreditoreve vleresohet e refuzuar.

3.Ne rastet kur shoqeria ngre padi si me siper , ajo merr pjese ne gjykim me ane te nje perfaqesuesi te posacem , te caktuar nga asambleja e pergjithshme .

4.Ortaket ose kreditorët e permendur ne piken 2 te ketij neni mund ti kerkojne gjykates zevendesimin e perfaqesuesit te posacem , kur ka dyshime te bazuara se perfaqesuesi i emeruar nga asambleja e pergjithshme mund te mos ngreje dhe ndjeke padine ne interesin me te mire te shoqerise.Nese gjykata e pranon kete kerkese , kostot e emerimit dhe te shperblimit te perfaqesuesit perballohen nga shoqeria.

5.Gjykata vendos shpalljen e pavlefshmerise se vendimit te administratoreve, nese keto nuk merren vesh , me pajtim ,me perfaqesuesin e posacem per korigjimin e pasojave te vendimit , brenda 30 diteve nga data e emerimit te ketij perfaqesuesi .Te drejtat e paleve te treta mbeten te pacenuara , ne perputhje me piken 3 te nenit 12 te ketij ligji.

6.Ortaket ne pakice dhe kreditorët e percaktuar me siper kane te drejtat e parashikuara ne pikat 2 dhe 4 te ketij neni , edhe ne rastin kur asambleja e pergjithshme nuk merr vendim , ose refuzon te vendose per kerkesen e tyre per ngritjen ndaj administratoreve te padise , me objekt shperblimin e demit te pesuar nga shoqeria, si vendim i paligjshem , apo per ngritjen e padive te tjera qe parashikon ky ligj ose statuti ndaj administratoreve apo ortakeve.

7.Dispozita e paragrafit 6 te nenit 91 te ketij ligji zbatohet edhe per keto padi.


NENI 24

TE DREJTAT E LIDHURA ME KUOTEN

Ortaku ,qe pengohet te ushtroje te drejtat qe i rrjedhin nga zoterimi i kuotes se shoqerise ka te drejte ti kerkoje gjykates te urdheroje ndalimin e cenimit apo shperblimin e demit te shkaktuar , si pasoje e cenimit te ketyre te drejtave. Kjo e drejte parashkruhet brenda 3 vjeteve nga casti i cenimit .

NENI 25

NDALIMI I KUFIZIMEVE



1. Jane te pavlefshme dispozitat e statutit , qe kufizojne ose perjashtojne ndonje nga te drejtat e ortakeve ose te kreditoreve, sipas percaktimeve te bera ne nenet 91,92 e 93 te ketij ligji , si dhe dispozitat , qe parashikojne kufizime te pergjithshme te veprimeve te percaktuara ne keto nene.

2. Vendimet e asamblese se pergjithshme nuk mund te cenojne te drejten e ortakeve ose te kreditoreve per te kryer veprimet e parashikuara ne nenet 91, 92 e 93 te ketij ligji.

ADMINISTRATORET

NENI 26

EMERIMI ,SHKARKIMI , TE DREJTAT DHE DETYRIMET

1. Asambleja e pergjithshme emerone nje ose me shum persona fizike si administratore te shoqerise . Afati i emerimit , i cili caktohet me statut , nuk mund te jete me i gjate se 5 vjete , me te drejte ripertesitje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas rregjistrimit ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit . Statuti mund te vendose rregulla te posacme per emerimin e administratoreve.

2. Administratoret e nje shoqerie tregtare meme , sipas percaktimit ne nenin 207 te ketij ligji , nuk mund te emerohen si administratore te nje shoqerie te kontrolluar e anasjelltas . Cdo emerim i bere ne kundershtrim me keto dispozita eshte i pavlefshem .

3. Administratoret kane te drejte te detyrohen te :

a) Te kryejne te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare , te vendosura nga asambleja e pergjithshme.

b) Perfaqesojne shoqerine tregtare

c) Kujdesene per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave e te librave kontabel te shoqerise.

ç) Pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor , bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe , se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve , i paraqesin keto dokumenta perpara asamblese se pergjithshme per miratim.

d) Krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat , qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise

dh) Kryejne rregjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Rregjistrimit.

e) Raportojne perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare.

f) Kryejne detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut

4. Ne rastet e parashikuara nga pikat 3 e 5 te nenit 82 te ketij ligji administratoret jane te detyruar te therrasin asamblene e pergjithshme .

5. Nese asambleja e pergjithshme emerone me shume se nje administrator , ata e administrojne bashkerrisht shoqerine.

6. Asambleja e pergjithshme mund te shkarkoje administratorin ne cdo kohe me shumicen e parashikuar ne nenit 18/4. Padite , qe lidhen me shperblimin e administratorit ne baze te marredhenieve kontraktore me shoqerine , rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

Administratori i shoqerise eshte **z. Ilir Fatmir Dabulla, lindur dhe banues ne qytetin e Lushnjes, datelindja 31.10.1982, me afat 5 vjecar me te drejte perseritje.**

NENI 27

PERFAQESIMI

- 1.Kufizimet e tagrave te perfaqesimit te administratoreve i kundrejtohen paleve te treta , ne perputhje me dispozitat e nenit 12 te ketij ligji.
- 2.Administratoret , qe perfaqesojne bashkerisht shoqerine tregtare , mund te autorizojne disa prej tyre per kryerjen e disa veprimeve te caktuara apo per kryerjen e disa kategorive te caktuara veprimesh.Njofitimet e drejtuara secilit prej administratoreve jane te vlefshme e detyruese per shoqerine.
- 3.Tagrat e perfaqesimit te administratoreve dhe cdo ndryshim i tyre njoftohen per regjistrim prane Qendres Kombetare te Rregjistrimit.
- 4.Administratoret mund te nenshkruajne kontrata vetem pasi te jene miratuar nga asambleja e pergjithshme .

NENI 28

SHPERBLIMI

- 1.Shperblimit baze te administratoreve mund ti behen shitesa , qe mund te jene perqindje ne fitim ose te ngjashme.
- 2.Shperblimi , sipas pikes 1 te ketij neni duhet te jete I pershtatshem dhe ne perputhje me detyrat e administratoreve dhe gjendjen financiare te shoqerise.
- 3.Nese shoqeria eshte ne veshtiresi financiare , asambleja e pergjithshme mund te vendose reduktimin e shperblimit te administratoreve ne masen e pershtatshme.
- 4.Kriteret e shperblimit , shperblimi individual dhe efekti vjetor i shperblimit te administratoreve ne strukturen e kostove te shoqerise tregtare publikohen se bashku me pasqyrat financiare vjetore.

NENI 29

DETYRIMI I BESNIKERISE DHE PERGJEGJESIA

- 1.Pervec sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise , sipas neneve 14,15,17 e 18 te ketij ligji , administratoret detyrohen :
 - a) Te kryejne detyrat e tyre te percaktuara ne ligj ose ne statut ne mirebesim dhe ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi duke i kushtuar vemendje te vecante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjedis.
 - b) Te ushtrojne kompetencat qe u njihen ne ligj ose ne statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita
 - c) Te vleresojne me pergjegjesi ceshtjet per te cilat merret vendim
 - d) Te parandalojne dhe menjanojne rastet e konfliktit ,prezent apo te mundshem , te interesave personale me ato te shoqerise.
 - e) Te garantojne miratimin e marreveshjeve sipas dispozitave te pikes 3 te nenit 13 te ketij ligji.
 - f) Te ushtrojne detyrat e tyre me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshem
2. Administratoret , gjate kryerjes se detyrave te tyre pergjigjen ndaj shoqerise per cdo veprim ose mosveprim , qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise tregtare , me perjashtim te rasteve kur , ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese , veprimi ose mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.

3. nese administratoret veprojne ne kundershkrim me detyrat dhe shkelin standartet profesionale sipas pikave 1 e 2 te ketij neni , jane te detyruar ti demshperblejme shoqerise demet ,qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe ti kalojne cdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregullta. Administratoret kane barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tyre ne menyre te rregullt dhe sipas standarteve te kerkuara . Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje administrator, ata pergjigjen ndaj shoqerise ne menyre solidare.

4. Ne menyre te vecante , por pa u kufizuar ne to , administratoret jane te detyruar ti demshperblejme shoqerise demet e shkaktuara , nese , ne kundershkrim me dispozitat e ketij ligji , kryejne veprimet e meposhtme:

- a) U kthejne ortakeve kontributet
- b) U paguajne ortakeve interesa apo dividente
- c) U shperndajne aktivet shoqerise
- d) Lejojne qe shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregtare, kur , ne baze te gjendjes financiare, duhet te parashikohej qe shoqeria nuk mund te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet .
- e) Japin kredi

6. Dispozitat e pikes 6 te nenit 92 te ketij ligji zbatohen edhe per padite, qe rrjedhin nga paragrafet e ketij neni . Keto padi duhet te ngrihen brenda 3 vjeteve nga kryerja e shkeljes apo nga zbulimi i saj.

KAPITULLI V

PRISHJA E SHOQERISE , LARGIMI DHE PERJASHTIMI I ORTAKEVE

KREU I

PRISHJA E SHOQERISE

NENI 30

SHKAQET E PRISHJES SE SHOQERISE

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar prishet :

- a) Kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj
- b) Me vendim te asamblese se pergjithshme
- c) Me hapjen e procedurave te falimentimit
- d) Nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per 2 vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr. 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit"
- e) Me vendim te gjykates
- f) Per asrye te tjera te parashikuara ne statut

NENI 31

REGJISTRIMI I SHPERBERJES



Administratoret regjistrojne prishjen e shoqerise prane Qendres Kombetare te Regjistrimit ne perputhje me nenin 43 te ligjit nr.9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".Nese prishja e shoqerise behet me vendim gjykate, gjykata ne perputhje me nenin 45 te ligjit nr. 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" ia njofton vendimin Qendres Kombetare te Regjistrimeve per regjistrim.

KREU II

LARGIMI DHE PERJASHTIMI I ORTAKEVE

NENI 32

LARGIMI I ORTAKUT PER SHKAQE TE ARSYESHME

- 1.Ortaku mund te largohet nga shoqeria nese ortaket e tjere ose shoqeria kane kryer veprime ne dem te tij, nese eshte penguar te ushtrroje te drejtat e tij , nese shoqeria i ka ngarkuar detyrime te paarsyeshme apo per shkaqe te tjera , qe e bejne te pamundur vazhdimin e ortakerise.
- 2.Ortaku qe kerkon largimin , duhet te njoftoje shoqerine me shkrim , si dhe te parashtrroje shkaqet e largimit .
- 3.Administratoret duhet te therrasin mbledhjen e asamblese se pergjithsme menjehere pasi te kene marre dijeni per njoftimin e largimit , sipas pikes 2 te ketij neni , per te vendosur nese ortakut do ti likujdohet kuota , si pasoje e largimit per shkaqe te arsyeshme.
- 4.Ortaku ka te drejte te ngreje padi ne gjykate ndaj shoqerise per likujdimin e kuotes, si pasoje e largimit per shkaqe te arsyeshme , nese pas njoftimit te largimit asambleja e pergjithshme nuk mblidhet ose nuk i njeh si te arsyeshme shkaqet e largimit dhe likujdimin e kuotes.
- 5.Ortaku qe kerkon largimin nga shoqeria , detyrohet ta demshperbleje shoqerine per demet e shkaktuara , nese rezulton se largimi eshte kryer ne baze te shkaqeve te paarsyeshme .
- 6.Ortaku qe largohet ka te drejte te ngreje padi ndaj shoqerise dhe /ose ortakeve te tjere qe shkaktuan largimin e tij dhe te kerkojne ndaj tyre , ne menyre solidare, shperblimin e demit te pesuar.

NENI 33

PERJASHTIMI I ORTAKUT

- 1.Asambleja e pergjithshme mund ti kerkoje gjykates perjashtimin e ortakut , nese ai nuk ka shlyer kontributin e tij , sipas parashikimeve te statutit ose nese ekzistojne shkaqe te tjera te arsyeshme per kete perjashtim .
- 2.Konsiderohen shkaqe te arsyeshme per perjashtimin e ortakut , sipas pikes 1 te ketij neni ,por pa u kufizuar ne to , rastet kur ortakut :
 - a) Me dashje apo me pakujdesi te rende i shkakton deme shoqerise ose ortakeve te tjere
 - b) Me dashje apo me pakujdesi te rende shkel statutin ose detyrimet e percaktuara me ligj
 - c) Perfshihet ne veprime , te cilat e bejne te pamundur vazhdimin e marredhenieve midis shoqerise tregtare dhe ortakut ,ose
 - d) me veprimet e tij demton ose pengon ndjeshem veprimtarine tregtare te shoqerise.

3. Gjate procedures se perjashtimit te ortakut , me kerkese te paditesit , gjykata mund te marr nje mase per sigurimin e padise , duke pezulluar te drejten e votes se ortakut , qe kerkohet te perjashtohet , si dhe te drejtat e tjera , qe rrjedhin nga zoterimi i kuotes se shoqerise , kur ajo e vlereson kete mase si te nevojshme dhe te justifikuar .
4. Shoqeria ka te drejte ti kerkoje ortakut te perjashtuar shperblimin e demit te pesuar nga veprimet qe kane sjell perjashtimin.
5. Ortaku ka te drejte ti kerkoje shoqerise shperblimin e demit te pesuar , nese kerkesa per perjashtim nuk eshte e bazuar .
6. Ortaku nuk ka te drejte ti kerkoje shoqerise likujdimin e kuotes , nese ai perjashtohet per shkaqe te arsyeshme , por , nese shoqeria ngre ndaj tij padi per shperblim demi , ortakut ka te drejte te kompesoje cdo shume , qe do te kishte ta perfitonte ne cilesine e likujdimit te kuotes , me demin e kerkuar nga shoqeria.

NENI 34

PASOJAT E LARGIMIT DHE PERJASHTIMIT

1. Te gjitha te drejtat qe rrjedhin nga cilesia e ortakut ne shoqeri , shuhen ne daten e largimit ose te vendimit te formes se prere te gjykates per largimin ose perjashtimin .
2. Statuti nuk mund te perjashtoje apo te kufizojte te drejten e ortakut per tu larguar nga shoqeria dhe te drejten e shoqerise per te perjashtuar ortakun.

NENI 35

LIKUJDIMI NE GJENDJEN E AFTESISE PAGUESE

Me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi , prishja e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar ka si pasoje hapjen e procedurave te likujdimit ne gjendjen e aftesise paguese sipas neneve 190 deri ne 205 te ketij ligji.

Tirane me 09 Maj 2019

ORTAKU I VETEM

(Ilir DABULLA)



